



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.2315/2 prot.

Datë 21.09.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Andi Hamo” P.F. në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-78327-08-25-2023 me objekt “NSHP, Skrep me kovë të parë 1.2m³ dhe kovë të pasme 0.5m³”, me fond limit 5,700,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 08.09.2023 nga autoriteti kontraktor Ndermarrja e Sherbimeve Publike Vlore.

Ankimues: “Andi Hamo” P.F. me NIPT K76926201W dhe Adresë Lagjia “Kushtrimi”, Rruga Transballkanike, Banesëprivate, pranë ish Agjensisë së Vjetër, Vlorë.

Autoriteti Kontraktor: Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Vlorë
Lagjia “Kushtrimi”, Rruga “Dervish Hekali”, Vlorë.

Në datën 20.09.2023 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2023/3435 dhe me nr. 2315 prot., datë 20.09.2023 e operatorit ekonomik “Andi Hamo” P.F.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Andi Hamo” P.F.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime” Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori

ekonomik “Andi Hamo” P.F., kundërshton me anë të ankesës me numër ankimi elektronik elektronik A/2023/3435 dhe me nr. 2315 prot., datë 20.09.2023.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyen e skualifikimit si më poshtë vijon:

“-Operatori ekonomik nuk plotëson Shtojcën 5 të specifikimeve teknike perkatesisht është kërkuar pesha e mjetit deri në 8.1 ton dhe është ofruar me e madhe se maksimumi I kërkuar nga Autoriteti Kontraktor duke e paraqitur 9.1 ton. -Është kërkuar kova e pasme me kapacitet 0.5m3 dhe nga Operatori Ekonomik është ofruar 0.36 m3 dhe si rrjedhojë kjo diferencë prej 28% bën që koha dhe shpenzimet për kryerjen e punimeve të jetë me e madhe nga sa parashikohet në buxhetin e Ndërmarrjes. -Dokumenti i ngarkuar në sistem me emrin “TARGETA ORIGJINALE” nuk përputhet me katalogun perkatesisht pesha dhe fuqia.”

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 21.09.2023.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri